



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 19 mars 2021

Njoftim për shtyp

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut: shkurt, 2021

- Pas rënies në janar, **paraja e gjerë (agregati monetar M3^{1,2})**, në shkurt të vitit 2021, shënoi rritje mujore prej 0,8%, e cila më së shumti është për shkak të depozitave pa afat³, me një rritje më të ulët të depozitave afatshkurtra, dhe në kushte të rënies në depozitat afatgjata deri në dy vite dhe parave të gatshme në qarkullim. Norma vjetore e rritjes u përsheptua në shkurt dhe arriti në 9,7% kryesisht për shkak të rritjes në depozitave pa afat, depozitave afatshkurtra dhe parave të gatshme në qarkullim, në mes të një rënieje të depozitave afatgjata deri në dy vite.

Tabela 1. Totali i depozitave dhe kredive^{4,5} të sektorit joqeveritar

	sostojba (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	1.2021	2.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	1.2021	2.2021	1.2021	2.2021
Парична маса M4	455,834	468,912	469,050	486,989	484,490	488,223	8.9	9.8	6.9	6.9	7.7	8.2	-0.5	0.8
Парична маса M3	403,714	416,935	418,556	436,231	433,902	437,578	8.3	9.7	7.6	8.0	9.0	9.7	-0.5	0.8
од кои:														
Готови пари во оптек	37,891	41,125	41,667	43,701	43,405	43,293	21.3	26.3	24.9	21.0	27.3	23.2	-0.7	-0.3
Вкупни депозити	409,200	418,916	418,644	434,915	432,539	436,236	8.3	8.4	6.1	5.9	6.3	7.1	-0.5	0.9
од кои:														
Корпоративен сектор	108,138	110,550	112,505	123,212	119,518	120,083	12.5	11.2	8.0	10.1	12.0	13.7	-3.0	0.5
Во денари	75,876	77,609	79,641	86,323	82,808	82,885	13.8	9.3	5.4	5.4	9.2	9.7	-4.1	0.1
Во странска валута	32,261	32,941	32,865	36,889	36,709	37,198	9.5	15.9	14.9	22.8	18.8	23.7	-0.5	1.3
Домаќинства	275,574	280,512	278,469	285,216	285,657	289,395	8.6	8.7	6.1	4.6	4.7	5.2	0.2	1.3
Во денари	147,532	149,204	145,806	150,991	150,011	153,096	11.9	10.1	6.2	3.3	3.9	4.5	-0.6	2.1
Во странска валута	128,042	131,309	132,663	134,225	135,646	136,299	5.1	7.1	6.0	6.2	5.7	5.9	1.1	0.5
Вкупни кредити	343,702	352,718	352,824	357,296	356,943	358,476	5.8	6.6	7.3	4.7	4.6	4.4	-0.1	0.4
од кои:														
Корпоративен сектор	167,654	172,978	168,086	169,826	169,440	169,979	1.8	4.6	5.2	1.1	1.6	1.4	-0.2	0.3
Во денари	103,597	106,688	101,925	102,688	102,625	102,910	0.4	3.3	2.7	-0.9	-0.1	-0.5	-0.1	0.3
Во странска валута	64,057	66,290	66,161	67,138	66,815	67,069	4.0	6.9	9.3	4.3	4.3	4.5	-0.5	0.4
Домаќинства	174,634	178,384	183,431	185,814	185,851	186,847	10.1	8.8	9.5	8.0	7.4	7.1	0.0	0.5
Во денари	96,643	99,469	103,939	105,049	105,161	105,852	8.8	8.7	12.0	10.5	9.7	9.6	0.1	0.7
Во странска валута	77,990	78,916	79,492	80,765	80,689	80,995	11.9	8.9	6.4	5.0	4.6	4.1	-0.1	0.4

Burimi: BPRMV.

¹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, Banka Popullore përdor agregatin monetar M3 si një përkufizim i ri standard për parane e gjerë. Për qëllime analitike, agregati monetare M4 do të vazhdojë të llogaritet dhe publikohet.

²Agregatin monetar M1 e përbëjnë paratë e gatshme në qarkullim dhe depozitat pa afat. Agregati monetar M2 është i përbërë nga agregati M1 bashkë me depozitat afatshkurtra, ndërsa agregati monetare M3 (paraja e gjerë), përveç agregatit monetar M2 i përfshin edhe depozitat me maturitet nga një deri në dy vjet. Rrjedhimisht, agregati monetar M4 përbëhet prej agregatit monetar M3 dhe depozitat afatgjate me maturitet mbi dy vjet. Për shpjegim më të hollësishëm, shihni Metodologjinë: http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_monetarna_07_2018_mak.pdf

³Paratë e depozitave i referohen llogarive rrjedhëse në banka dhe shtëpi kursimesh dhe llogarive rrjedhëse të institucionet tjera financiare në Bankën Popullore


⁴Normat vjetore të kredive në periudhën nga korriku 2019 këndejanë nën ndikimin e efekteve nga masat e BPRMV-së për fshirjen e kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit.

⁵Të dhënat për agregatet monetare, si dhe totali i depozitave dhe kredive deri në gusht të vitit 2020, nuk i përfshijnë të dhënat për një bankë të cilës në gusht të vitit 2020 i është revokuar leja për themelim dhe punë dhe për të cilën është iniciuar një procedurë falimentimi.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- **Depozitat totale⁶**, në shkurt ishin më të larta për 0,9%, në bazë mujore, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të sektorit të amvisërive, në mes të një rritjeje të moderuar të depozitave të sektorit të korporatave. Në bazë vjetore, depozitat totale u rritën për 7,1%, me një rritje pothuajse të barabartë të depozitave në të dy sektorët.
- Në shkurt, **kreditë totale⁷**, shënojnë rritje mujore prej 0,4% ndërsa në bazë vjetore janë më të larta për 4,4%. Ndryshimi në rritje në bazë mujore dhe vjetore është si rezultat i huadhënies së rritur në të dy sektorët, me një kontribut më të lartë ndaj rritjes nga sektori i amvisërive.



Burimi: BPRMV.



1. Депозитат dhe kreditë e sektorit të korporatave⁸



Burimi: BPRMV.

⁶Totalin e depozitave e përbëjnë të gjithë depozitat e përfshirë në agregatin monetare M4.

⁷ Më 9 gusht të vitit 2018, Këshilli i Bankës Popullore e miratoi Vendimin mbi metodologjinë për administrimin e rrezikut të kredisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 149/18), sipas së cilës bankat janë të detyruara t'i transferojnë nga evidenca e bilancit në evidencë jashtë bilancit (dhe të vazhdojnë me transferimin e) të gjithë kredive që janë plotësisht të mbuluara për më shumë se një vit. Vendimi për metodologjinë e administrimit të rrezikut të kredisë filloi të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2019, duke shterur kështu efektin e bazës së krahasimit në korrik të vitit 2020. Prandaj, ndryshimet në normat vjetore të ndryshimit të kredive me dhe pa efektin e fshirjeve të kryera janë të parëndësishme, për shkak të së cilës nga njoftimi i muajit gusht këndeje këto krahasime janë ndërprerë.

⁸Për nevojat e këtij njoftimi, sektori i korporatave i përfshin korporatat publike dhe private jofinanciare.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Depozitat **totale të sektorit të korporatave**, në shkurt u rritën për 0,5% në bazë mujore. Rritja në masë të madhe është si rezultat i rritjes së depozitave afatshkurtra në valutë të huaj dhe depozitave pa afat, në kushte të rënies në depozitat afatgjata në denarë. Analizuar në bazë vjetore, depozitat e sektorit të korporatave janë më të larta për 13,7%, për shkak të rritjes së depozitave pa afat dhe depozitave afatshkurtra dhe afatgjata në valutë të huaj, gjatë një rënijeje në depozitat afatshkurtra dhe afatgjata në denarë.
- Në shkurt, **kreditë e sektorit të korporatave**⁹ shënojnë rritje një rritje mujore prej 0,3% me një rritje thuajse të barabartë të huadhënies në denarë dhe valutë të huaj (pak më e shprehur në kreditë në denarë). Në bazë vjetore, kreditë e sektorit të korporatave janë më të larta për 1,4% tërësisht si rezultat i rritjes së kredive në valutë të huaj.



Burimi: BPRMV.

2. Depozitat dhe kreditë e amvisërive¹⁰



Burimi: BPRMV.

- Në **depozitat totale të amvisërive**, në shkurt, u regjistrua një rritje mujore prej 1,3%, në masë të madhe si rezultat i depozitave pa afat, me një rritje më të vogël në depozitat afatshkurtra në valutë të huaj. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, këto

⁹Duke filluar nga qershori i vitit 2018, dhe në pajtim me metodologjinë e re, të dhënat për instrumentet financiare në denarë me klauzolë valutore janë përfshirë në kuadër të valutës së huaj.



¹⁰Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë u referohen personave fizikë dhe personave të vetëpunësuar.




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

depozita janë rritur për 5,2%, tërësisht nën ndikimin e depozitave më të larta pa afat dhe depozitave afatshkurtra në monedhë të huaj, në kushte të rënies në komponentët tjerë.

- Në shkurt, **kreditë e amvisërive** janë rritur për 0,5% dhe 7,1%, në bazë mujore dhe vjetore, përkatësisht. Analizuar sipas valutës, kreditë në denarë kanë kontribut më të shprehur në ndryshimin në rritje në bazë mujore dhe vjetore.



Burimi: BPRMV.



Burimi: BPRMV.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Tabela 2. Kredi të bankave dhe shtëpive të kursimeve të dhëna personave fizikë, sipas qëllimit

	состојба (во милиони денари)						годишна промена (во %)						месечна промена (во %)	
	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	1.2021	2.2021	3.2020	6.2020	9.2020	12.2020	1.2021	2.2021	1.2021	2.2021
Потрошувачки кредити	93,440	94,982	97,850	98,772	98,023	98,601	13.5	10.0	9.9	6.9	6.3	6.0	-0.8	0.6
Станбени кредити	52,959	54,392	55,985	58,306	58,548	59,229	13.9	13.8	14.0	13.6	13.0	12.7	0.4	1.2
Автомобилски кредити	306	292	291	282	276	267	-4.1	-8.6	-7.9	-10.9	-10.5	-13.0	-1.9	-3.3
Кредитни картички	11,570	11,508	11,649	11,205	10,900	10,644	-4.5	-4.2	-2.6	-6.1	-8.0	-9.2	-2.7	-2.3
Негативни салда по тековни сметки	6,499	6,205	6,280	5,818	6,352	6,258	-4.8	-9.4	-10.8	-5.0	-8.1	-9.3	9.2	-1.5
Други кредити	3,969	3,946	3,912	3,871	3,800	3,763	-6.7	-6.4	-6.7	-6.0	-6.9	-6.7	-1.8	-1.0

Burimi: BPRMV.

- Në shkurt, analizuar sipas qëllimit të kredive të miratuara për personat fizikë, **kreditë konsumatore dhe banesore**, si kategori më të zakonshme shënojnë një rritje prej 0,6% dhe 1,2%, përkatësisht, si dhe një rritje vjetore prej 6,0% dhe 12,7%, përkatësisht. Në **kreditë për automjete**, këtë muaj ka pasur një rënie për 3,3% dhe 13,0%, në bazë mujore dhe vjetore, përkatësisht. Kreditë e miratuara të **kartave të kreditit**, në shkurt shënojnë rënie mujore prej 2,3% dhe 9,2%, përkatësisht, ndërsa saldot negative në llogaritë rrjedhëse janë ulur për 1,5% dhe 0,3% në bazë mujore dhe vjetore, përkatësisht. Në kreditë e miratuara në **baza tjera**, këtë muaj, është regjistruar një rënie mujore dhe vjetore prej 1,0% dhe 6,7%, përkatësisht.

Informacione shoqëruese

Të dhënat e serive kohore: Balance dhe pasqyra të institucioneve depozituese, të dhëna mujore http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika.nspk

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_monetarna_07_2018_mak.pdf

Informacion për ndryshimet metodologjike në statistikën monetare, statistikën e institucioneve tjera financiare dhe statistikën e normave të interesi:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/informacii/Informacija_za_promeni_vo_monetarnata_statistika_mk.pdf



**Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Drejtoria për Statistikë**

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimi të të dhënave

http://nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_na_objavuvanje_podatoci.pdf

Zhvillime monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut 21 prill i vitit 2021 (mesatare referuese mars 2021).

Për pyetje gazetarësh, ju lutemi kontaktoni me personat e Kabinetit të Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme lidhur me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit 02 3215 181 lokali 116 (ose 110/108).